



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS
Teknika të Redaktimit dhe të Shprehjes

Ngarkesa: 3 kredite, 30 orë mësimore në klasë, 30 seminare

Viti / Semestri : Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: *Master i shkencave "Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim"*,

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të ofrojë njohuri themelore mbi procesin e redaktimit dhe rishikimit në kontekstin e përkthimit. Të formojë kuptimin profesional mbi rolin e redaktuesit dhe rishikuesit si pjesë thelbësore e ciklit të përkthimit. Të nxisë aftësitë e studentëve për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë e një përkthimi, si të vetin, ashtu edhe të të tjerëve.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë studentët me llojet e redaktimit (gjuhësor, profesional, stilistik, përkthredaktim) dhe rolin e secilit në cilësinë përfundimtare të tekstit.
2. Të aftësojë studentët të identifikojnë dobësitë në përkthime dhe të zbatojnë teknika të rishikimit pa e shndërruar procesin në korrigjim të drejtpërdrejtë.
3. Të përdorin mjetet kompjuterike dhe teknologjike në procesin e redaktimit dhe vetëredaktimit, për të përmirësuar rrjedhën, kohezionin dhe korrektësinë e tekstit.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:

1. Analizojnë dhe rishikojnë përkthimet me një sy kritik profesional, duke identifikuar pikat e dobëta dhe ato që kërkojnë përmirësim.
2. Aplikojnë teknikat e redaktimit dhe përkthredaktimit për të përmirësuar qartësinë, koherencën dhe stilin e përkthimit.
3. Vlerësojnë cilësinë e një përkthimi jo vetëm nga aspekti gjuhësor, por edhe nga ai funksional dhe përdorues, në përputhje me kërkesat e kontekstit dhe audiencës.